

## HAPPEL: GJIMNAZI “LOYOLA”, MODEL I ARSIMIMIT CILËSOR



*“Ruajeni dinjitetin, mbështetuni në përpjekjet dhe punën tuaj, në vend të lidhjeve dhe parave. Punoni shumë, bëhuni të suksesshëm dhe pastaj do të jeni krenarë dhe do të kënaqeni me frytet e punës suaj”, - porositi themeluesi dhe drejtori i “Loyola-Gymnasium” në Prizren, P. Walter Happel*

**Lajm:** I nderuar z. P. Happel, ju lutemi që në fillim të kësaj interviste të shpalosni përmbledhurazi punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti akademik (2012-2013) në “Loyola-Gymnasium”.

**Walter Happel:** Kemi pasur një vit shkollor normal, me aktivitete të zakonshme, shkëmbim të nxënësve të klasave të nënta në Gjermani me shkollat e atjeshme, kremtimin e ditës së shkollës- Ditën e dyerve të hapura. Dhe, natyrisht kishim provimin e maturës që doli ashtu siç e kemi pritur me kalueshmëri 100 %. Pra, arsimtarët tanë, kanë bërë punë të mirë, ashtu si edhe fëmijët tanë.

**Lajm:** Viti shkollor tanimë ka përfunduar dhe ju sigurisht keni bërë bilancin e sukseseve dhe të arritjeve. Çka mund të thoni lidhur me këtë?

**Walter Happel:** Siç e përmenda më parë, kemi pasur rezultate shumë të mira në testin e maturës, shkolla ka fituar një reputacion në mesin e popullatës, sepse kemi më shumë aplikime për t’u regjistruar te ne, sesa që kemi vende të lira dhe kjo është si rezultat i kualitetit të mësimdhënies, mënyrës se si veprojmë me njëri-tjetrin dhe programi ynë edukativ-pedagogjik.

**Lajm:** “Loyola-Gymnasium” ka përfunduar procesin e regjistrimit të nxënësve për vitin e ardhshëm shkollor. Sa jeni të kënaqur me interesimin e nxënësve dhe prindërve të tyre për të sjellë fëmijët e tyre në këtë shkollë?

**Walter Happel:** Vitin e ardhshëm shkollor do ta fillojmë me tri klasë të reja të gjashta, vendet janë plotësuar tashmë. E njëjta gjë vlen edhe për klasën

e dhjetë dhe mendoj se të gjithë do të jemi të kënaqur.

**Lajm:** Si e vlerësoni rezultatin e provimit pranues në afatin e qershorit dhe cilat janë të arriturat e kandidatëve të paraqitur?

**Walter Happel:** Provimi pranues çdo vit tregon dallimin që ekziston në mes pjesës rurale dhe qytetit e po ashtu edhe brenda qytetit. Në përgjithësi shumica e nxënësve ngecin në matematikë, ndërsa në dy lëndët tjera të provimit pranues, në gjuhë shqipe dhe gjuhë angleze rezultatet janë mesatare, ndonjëherë edhe të mira. Kjo është arsyeja pse ne fillojmë me klasën e gjashtë, sepse është një kohë më e gjatë derisa të arrijmë te testi i maturës d.m.th. një kohë më e gjatë për t'i mësuar dhe edukuar nxënësit dhe ta sjellim në jetë kreativitetin dhe talentin e tyre. Një përparësi e jona është se ne ofrojmë kushte mjaft të mira edhe për nxënësit e interesuar nga qytetet tjera, por edhe jashtë Kosovës, përmes mundësisë që ata të vendosen në konviktet tona me të cilët punon stafi i edukatorëve. Kemi nxënës edhe nga shtetet përreth, numër që çdo vit po rritet që e konsiderojmë si sinjal të vlerësimit të punës dhe përkushtimit tonë.

**Lajm:** Një program i rëndësishëm që ju zbatoni është dërgimi në Gjermani i nxënësve pas mbarimit të shkollimit në "Loyola-Gymnasium". Si po ecin punët në këtë drejtim dhe cilat janë pritjet tuaja nga ky program shumë i dobishëm për të rinjtë dhe të rejtat e këtij vendi?

**Walter Happel:** Së pari ky është një rast shumë i mirë për nxënësit që e kryejnë maturën te ne për të arritur një arsimim të mirëfilltë në Gjermani, paralelisht me arsimimin universitar. Kjo së pari hap perspektiva individuale të nxënësve dhe ata zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre të cilat në një afat më të gjatë mund të jenë të frytshme e të dobishme për vendin, Kosovën. Natyrisht nxënësit tanë duhet të punojnë shumë; ata jo vetën që duhet ta kalojnë maturën shtetërore të Kosovës, mirëpo duhet ta kenë edhe diplomën e brendshme të "Loyola- Gymnasium" dhe diplomën e gjuhës gjermane. Këto janë tri diplomat të cilat tregojnë se çka kërkohet gjatë këtyre viteve të shkollimit.

**Lajm:** Risi e veçantë për sistemin e shkollimit në Kosovë është dhe hapja e paraleleve të shkollës fillore "Loyola". Çfarë motivesh ju shtynë të ndërmerri një vendim të tillë?

**Walter Happel:** Ka motive të ndryshme, njëri është se shumë prindër kanë qenë të interesuar dhe kanë pyetur pse nuk hapet shkolla fillore. Ndërkohë e kam konsideruar sfidë për të pasur shkollën fillor që do të shërbente si shembull inspirues që të përgatiten në mënyrë të suksesshme këta nxënës, për kërkesat e arsimit të gjimnazit.

**Lajm:** Z. P. Happel, çka vlerësoni si problemin më

një ambient të tillë ku para sistemit arsimor dalin obligime dhe detyra të rëndësishme për përparimin dhe edukimin e brezave të rinj?

**Walter Happel:** Mendoj se sfida e vërtetë është mentaliteti sipas të cilit notat në shkollë janë të negociueshme dhe nuk ka nevojë të mësoh, mjaftojnë lidhjet. Njerëzi nuk e kuptojnë se gjithë ajo radhitje e notave, shkallë e notave shfrytëzohet, ata presin pesëshe në çdo lëndë, ndonëse siç e tregon provimi pranues dijenia është nën mesatare. Dhe ky është presioni që arsimtarët e ndiejnë shumë, mirëpo ne këtë dukuri po e luftojmë me kohë dhe po rezistojmë ndaj me sukses.

**Lajm:** Një intelektual si ju me përvojë të gjatë jetësore e profesionale në punën me nxënës, sigurisht ka një mesazh për të rinjtë dhe të rejtat e këtij vendi dhe rrugën jetësore që ata duhet të ndjekin.

**Walter Happel:** Unë dua t'i këshilloj që ta ruani dinjitetin tuaj, të mbështetuni në përpjekjet dhe punën tuaj, në vend të lidhjeve dhe parave. Lidhjet dhe paratë mund ta blejnë suksesin tuaj, por kjo nuk zgjat shumë dhe nuk respektohet nga njerëzit e ndershëm. Punoni shumë, bëhuni të suksesshëm dhe pastaj do të jeni krenarë dhe do të kënaqeni me frytet e punës suaj.

**Lajm:** Çka dëshironi t'i shtoni kësaj interviste, që ne nuk ju kemi pyetur?

**Walter Happel:** Dua t'ju falënderoj për këtë intervistë dhe të shfrytëzoj rastin të ftoj secilin që ka ide që na ndihmojnë, t'i ndajnë ato me mua apo arsimtarët tanë, sepse ne e dimë se vazhdimisht duhet të punojmë për ta përmirësuar punën tonë dhe të arrijmë rezultate sa më të larta.